



Qeveria e Republikës së Maqedonisë -
Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

në bashkëpunim me
Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave – Trupi drejtues me IPARD
më 16 korrik të vitit 2011

publikojnë

THIRRJE PUBLIKE nr. 02/2011

Për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD programi 2007-2013

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2007, 05/2009) dhe në pajtueshmëri me Programin për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë para-pranuese për bujqësi dhe zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 83/2009), shpallet thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin IPARD programit 2007-2013 për masat në vijim:

- **Masa 101** – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritje të standardeve të Unionit Evropian ku të pranueshme janë ato projekte që shumica e përgjithshme për harxhime të pranueshme është prej minimum 5,000 eurove (në kundërvlerë prej 308.031,50 denarë) dhe maksimum 400.000 eurove ose në kundërvlerë prej 24.642.520,00 denarë,
- **Masa 103** – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit Evropian ku projekte të pranueshme janë ato të cilat shumica e përgjithshme e tyre për harxhime të pranueshme është mes 15.000 eurove (në kundërvlerë prej 924.094,50 denarë) dhe 800.000 eurove (në kundërvlerë prej 49.285.040,00 denarë) me përjashtim të investimeve për vendosje të kapaciteteve të thertoreve për kafshët ku projekte të pranueshme janë ato projekte që shumica e përgjithshme për harxhime të pranueshme nuk kalon shumën prej 3.000.000 eurove (në kundërvlerë prej 184.818.900,00 denarë), dhe,
- **Masa 302** – Diverzifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale ku projekte të pranueshme janë ato të cilat shumica e përgjithshme e tyre për harxhime të pranueshme është mes 5.000 eurove (në kundërvlerë prej 308.031,50 denarë) dhe 200.000 eurove (në kundërvlerë prej 12.321.260,00 denarë).

Për masën 101 dhe masën 103 kërkesë mund të dorëzojnë persona ligjor dhe fizik për investime në cilëndo pjesë të Republikës së Maqedonisë, ndërsa për masën 302 mund të dorëzojnë kërkesë për investime që gjenden në hapësira rurale.

Buxheti i paraparë indikativ për këtë Thirrje publike është gjithsej 18.565.000.00 euro (në kundërvlerë prej 1.143.720.959,50 denarë), prej të cilave 75% të mjeteve janë të siguruara nga komponenti i pestë i Instrumentit për ndihmë gjatë para-pranimit për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) dhe 25% të mjeteve janë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesës, si dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 mund të merren në ueb faqen e internetit www.ipardpa.gov.mk, si dhe personalisht në recepcionin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe në zyrat rajonale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej orës 8:30 deri më 16:30.

Kërkesat për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 me dokumentacionin e vërtetuar të dorëzohen detyrimisht me zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm "MOS E HAP" për Thirrjen Publike 2/2011 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesat duhet të dorëzohen përmes postës në adresën: "Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural", bul. 3 - ta Makedonska Brigada pa nr. (ndërtesa Makedonija Tabak, bloku C), 1000 Shkup ose personalisht duke dorëzuar në recepcionin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural çdo ditë pune nga dita e publikimit të kësaj shpallje, duke përfshirë edhe vet ditën e afatit përfundimtar për dorëzimin e kërkesave. Vërejtje: Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 dhe dokumentacioni shtesë i dorëzuar NUK KTHEHEN. Për shkak të kontrollimit në fushë është e nevojshme që kërkuesi me vete të bartë kopje të tërë dokumentacionit të dorëzuar deri tek Agjencia

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 30.08.2011

Kontaktet për informata më të detajuara:

tel: 02 3097-460

faks: 02 3097-454

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk